



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VORË

INSPEKTORIATI I MBROJTJES SË TERRITORIT

Nr. 01 prot.

Vorë, më 08 . 01 .2026

Lënda: Kthim përgjigje

**KORDINATORES PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

Këtu

Në përgjigje të kërkesës së paraqitur nga Qendra “Res Publica” me nr. 146/25 prot, protokolluar pranë Bashkisë Vorë me nr. 6237 prot, date 18.12.2025, me lëndë “Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion e dokumentacionit”, lidhur me veprimtarinë e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit (IMT) për periudhën **01.01.2025 – 17.12.2025**, ju informojmë si më poshtë:

1. Gjatë periudhës së sipërcituar, nga IMT janë konstatuar gjithsej **34 (tridhjetë e katër)** raste ndërtimesh pa leje, të pasqyruara në aktet përkatëse të konstatimit.
2. Në vijim të këtyre konstatimeve, janë marrë **34 (tridhjetë e katër)** masa administrative me gjobë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Gjithashtu, janë nxjerrë **32 (tridhjetë e dy)** vendime administrative për prishje objekti / kthim në gjendjen e mëparshme.
4. Sa i përket ekzekutimit të masave:
  - o në lidhje me masat administrative me dënim me gjobë, janë dërguar pranë gjykatës kërkesat për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit, për vijimin e mëtejshëm të procedurës së vjeljes së gjobave.
  - o për shkak të mungesës së mjeteve dhe kapaciteteve teknike, vendimet për prishje objekti nuk janë ekzekutuar;
5. Në lidhje me të drejtën e ankimit, rezulton se është ankimuar **1 (një)** masë administrative.

Sqarojmë se informacioni i mësipërm bazohet në raportet dhe evidencat zyrtare të IMT për periudhën e kërkuar dhe pasqyron gjendjen faktike në momentin e dhënies së këtij informacioni.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

**KRYEINSPEKTOR I IMT  
KLEVIS PICARI**

Konceptoi: Alesio Gjoka

Konfirmoi: Klevis Picari

Miratoi: Klevis Picari

Nr.Kopjeve: 3 (kopje)